

LUDMILA BUXHELI

FJALËFORMIMI NË GRAMATOLOGJINË SHQIPTARE

Nisur nga bibliografia e pasur e botimeve për formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, në këtë kumtesë bëhet një vështrim i arritjeve kryesore të studiuesve të gjuhës shqipe në fushën e fjalëformimit. Paraqitja ka karakter kronologjik dhe tematik dhe synon të vërë në dukje traditën e pasur të gramatologjisë shqiptare në fushën e studimit të formimit të fjalëve. Në fund jepen disa përfundime lidhur me problemet që dalin para studiuesve të kësaj fushe.

Njohja me studimet e botimet në fushë të shqipes tregon se struktura fjalëformuese ka qenë një nga objektet e studimit të fjalëve të shqipes si nëpër artikuj të veçantë, ashtu edhe nëpër gramatika. Interesimi për këtë fushë ka qenë si nga studiues shqiptarë, ashtu edhe nga studiues të huaj. Arsyet janë disa, por dy mendojmë se janë kryesoret: Së pari, qoftë historikisht, por edhe nga pozitat e shqipes së sotme, pasurimi i leksikut të shqipes me fjalë të reja nëpërmjet mënyrave, tipave dhe mjeteve fjalëformuese ka qenë dhe mbetet një proces gjuhësor shumë dinamik e i pandalshëm. Së dyti, kjo veçori e leksikut të shqipes për pasurimin e tij nëpërmjet mënyrave të ndryshme fjalëformuese shtronte dhe vijon të shtrojë para gjuhëtarëve njohjen e strukturës fjalëformuese të shqipes, qoftë për interesa shkencore, por edhe për interesa praktike që kanë të bëjnë me nevojat e shkollës¹. Pra, në vija të përgjithshme, në varësi të kushteve dhe rrethanave historike-shoqërore, vërehet se interesimi për këto studime mund të shpjegohet edhe me nevojat praktike për mësimin e gjuhës shqipe, edhe me interesa teorike të gjuhëtarëve.

1. Para viteve '50 të shek. XX studimet mbi fjalëformimin ishin shumë të pakta dhe jo rezultat i një pune të organizuar dhe të planifikuar. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, edhe pse mungonin studimet e plota, përgjithësuese, për sistemin fjalëformues të shqipes, studimi i A. Xhuvanit, *Prejardhja e pjesavet të fjalës në gjuhën shqipe* (1906) dhe më pas i N. Joklit, *Naim Be Frashëri e pasurimi i gjuhës shqipe* (1925) paraqesin interes për kohën dhe historinë e analizës së problemeve të fjalëformimit. Në këto dy punime hidhet dritë mbi dy rrugët kryesore të fjalëformimit në gjuhën shqipe: ndajshitesimi dhe kompozimi. Nuk mungojnë para viteve '50 të shek. XX të dhëna mbi fjalëformimin edhe në disa fjalorë të paraqilimit si: *Dictionarum latino epiroticum* (1635) i F. Bardhit, *Αλβανο-ελληνικόν* (1904) i K. Kristoforidhit, *Fjalorth i ri* (1941) i N. Gazullit, etj. Po ashtu, disa dorëshkrime dhe shënime

¹ M. Domi, *Gjuhësia shqiptare në 35-vjetorin e çlirimit*, "Studime Filologjike", 1979/4, f. 8-9.

që kanë të bëjnë me fjalëformimin, ende të pa botuara të K. Kristoforidhit² dhe të A. Xhuvanit³, gjithashtu paraqesin interes për kohën.

Por fjala shqipe, që në gjysmën e dytë të shek. XIX, e deri në gjysmën e parë të shek. XX, ishte bërë objekt studimi sidomos në disa gramatika të shqipes, të hartuara kryesisht nga autorë shqiptarë dhe më rrallë nga të huaj. Ndër gramatikanët e parë shqiptarë që analizojnë formimin e fjalëve të shqipes sipas mënyrave dhe mjeteve fjalëformuese shquhen: Dh. Kamarda (1864), K. Kristoforidhi (1882), S. Frashëri (1886), Gj. Pekmezi (1908), A. Xanoni (1909), I. D. Sheperi (1927), O. Myderrizi (1944). Kurse ndër gramatikanët e huaj që kanë trajtuar fjalëformimin e shqipes në përmendim J. Hahn (1854), A. Dozon (1879), G. Weigand (1913). Në përgjithësi, në këto gramatika, të hartuara kryesisht për nevoja praktike, provohet se në gjuhën shqipe fjalët jo të parme formohen në mënyra të ndryshme, por dy janë kryesore: prejardhja dhe kompozita. Megjithatë këtyre gramatikave u mungon përshkrimi i plotë dhe sintetik i të gjitha mënyrave, tipave dhe mjeteve të fjalëformimit në shqip. Këto mangësi shpjegohen me disa arsye kryesore. Së pari, gramatikat e kësaj kohe ishin tekste shkollore; destinacioni i tyre si tekste shkollore kërkonte një trajtim të thjeshtëzuar të fjalëformimit, gjë që nuk mundësonte një trajtim të thelluar e me nivel të lartë teorik të problemeve të fjalëformimit. Së dyti, këto mangësi shpjegohen me natyrën e studimeve. Interesi për gjuhën shqipe nga ana e studiuesve/kërkuesve përgjatë kësaj faze shtrihet më shumë në planin krahasues; Së treti, por jo e fundit për nga rëndësia, mangësitë në studimet në fushën e fjalëformimit shpjegohen me shkallën e njohjes së gjuhës shqipe, në përgjithësi, dhe të leksikut të saj, në veçanti, sidomos nga studiuesit e huaj. Njohja e pamjaftueshme e leksikut të shqipes nga këta studiues ka ndikuar më pas në identifikimin dhe përshkrimin pjesërisht të pasaktë të strukturës fjalëformuese të shqipes. Konkretisht, njohja e pamjaftueshme e pasurisë leksikore të gjuhës shqipe ka çuar ndonjëherë edhe në shfaqjen e një qëndrimi skeptik të disa studiuesve të huaj nëpër gramatika për vendin dhe rolin e mënyrave specifike të fjalëformimit⁴. Kemi parasysh këtu tri nga gramatikat e

² K. Kristoforidhi, *Alfabeti i vitit 1860*, (kseroks).2 f. -Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, QSA.

³ A. Xhuvani, *Të prejardhunit e foljeve*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë, kopje e daktilografuar, dosja 41, faqe 75-81.

⁴ A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, BUSHT, SShSh, 3,1961, f. 8.

hershme për gjuhën shqipe, përkatësisht të Hahnit⁵, të Dozonit⁶ dhe të Vajgandit⁷ në të cilat kompozimit i mohohet roli i aktiv në gjuhën shqipe.

2. Në gjysmën e dytë të shekullit XX fjalëformimi në gjuhën shqipe u bë një fushë mjaft e studiuar si nga leksikologët, ashtu edhe nga gramatikanët. Ndryshe nga periudha paraardhëse, këto studime, ashtu si dhe studimet gjuhësore në përgjithësi, nuk kishin më karakter rastësor, por ishin rezultat i një pune të organizuar e të studiuar mirë, në përputhje me kërkesat e kohës që shtroheshin para institucioneve kërkimore-shkencore dhe të arsimit të lartë të krijuara gjatë kësaj kohe, si Universitetit Shtetëror të Tiranës në 1957 dhe më vonë Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë në 1972 ku bënte pjesë gjithashtu edhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, qendra më e rëndësishme shkencore në fushë të studimeve gjuhësore.

Ndërmarrja e studimeve në fushën e fjalëformimit u pa si një nevojë objektive ose domosdoshmëri e diktuar nga vetë realiteti ynë gjuhësor, nga ndryshimet, zhvillimi dhe pasurimi i mëtejshëm i gjuhës shqipe, të cilët reflektojnë gjithmonë transformimet në jetën ekonomike, sociale, kulturore, etj. Dihet që struktura leksikore dhe ajo e fjalëformimit janë strukturat më të hapura dhe më dinamike të gjuhës, të cilat në sajë të ndjeshmërisë së tyre reflektojnë më shpejt se të gjitha strukturat e tjera gjuhësore transformimet që ndodhin në jetën shoqërore. Në kushtet e një jete më sociale e më dinamike, procesi i pasurimit të leksikut të shqipes me fjalë të reja, duke i marrë nga gjuha e folur e popullit ose duke i krijuar me anë të mënyrave fjalëformuese është mjaft i vrullshëm. Nga ana tjetër, gjallërimi i shtypit letrar, publicistik e politik, krahas botimeve nga gjuha e folur, shërbeu si mjet për grumbullimin e një lënde leksikore mjaft të pasur e me të dhëna të rëndësishme për strukturën fjalëformuese të shqipes. Janë pikërisht të tilla ndryshime që e bënë shumë më të domosdoshëm studimin e thelluar të strukturës së fjalëformimit në të fjalëve të shqipes duke plotësuar boshllëkun e së shkuarës me studime të kësaj fushe, dhe duke sjellë ndihmesa të reja për njohjen më të thellë të strukturës fjalëformuese të kësaj gjuhe.

3. Tematika e studimeve për fjalëformimin gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX është e gjerë dhe e larmishme. Një vend të rëndësishëm zënë studimet për llojet e ndajshesave fjalëformuese të shqipes, si mjetet kryesore për pasurimin e leksikut me fjalë të reja. Për këtë arsye u hartuan monografi kushtuar tërësisht parashtesave dhe prapashtesave të shqipes. U ndërmorën gjithashtu studime mbi parashtesat ose prapashtesat e veçanta, ashtu si edhe studime mbi formimet parashtesore-prapashtesore. Një interes të veçantë

⁵ J. G. Hahn, *Beiträge zu einer Grammatik des toskischen Dialektes*. Albanesishe Studien, Jena, 1854, f. 45.

⁶ A. Dozon, *Manuel de langue chkepe ou albanais*, Paris, 1879, f. 285.

⁷ G. Weigand, *Albanesishe Grammatik im südgegischen Dialekt*, Leipzig, 1913, f. 43.

paraqesin dhe studimet për formimet me përbërje, përngjitje, me mënyrat e përziera. Një vend të veçantë në këtë fushë zënë punimet mbi çështje të ndryshme teorike lidhur me mënyrat e fjalëformimit (si p.sh. fjalët e përbëra, të përngjitura, dallimi ndërmjet prejardhjes parashtesore e përngjitjes ose kompozimit etj.).

Fjalëformimi është studiuar gjithashtu sipas pjesëve të ligjëratës (p.sh. formimi i emrave, i mbiemrave, i foljeve, etj.), por edhe sipas grupeve të ndryshme leksiko-semantike (emrat e veprimit, të profesioneve, etj.); ka gjithashtu disa përpjekje për trajtimin e problemeve të fjalëformimit në kuadrin e lidhjeve gjenetike të ngushta të shqipes me ilirishten, në sajë të të cilave fondi i njohur i konkordancave iliro-shqipe është zgjeruar.

Por, duke i ndjekur këto studime kronologjikisht, në fillimet e viteve '50 prurjet e para në analizën e fjalëformimit i gjejmë në veprën "Gramatika shqipe" I (1949) të K. Cipos, në vijim në punimet e K. Cipos për kompozitat determinative⁸ dhe të prof. A. Xhuvanit mbi origjinën dhe formimin e ndajfoljeve⁹, fjalët e përbëra¹⁰ e disa prapashtesa¹¹.

Punimet e këtyre studiuesve zgjuan interesin e kërkuesve shkencorë për thellim të mëtejshëm në këtë fushë. Kështu, më vonë, veprat e A. Xhuvanit dhe të E. Çabejt përkatësisht "Parashtesat e gjuhës shqipe" (1956) dhe "Prapashtesat e gjuhës shqipe" (1962) përbëjnë një sintezë të formimit parashtesor e prapashtesor të fjalëve, të para në plan sinkronik dhe diakronik. Edhe sot ato mbeten si veprat me analizat më të plota për sa i përket paraqitjes së përmbledhur të inventarit dhe të funksionit të parashtesave dhe prapashtesave në planin sinkronik dhe diakronik.

Më pas kalohet në një fazë të re të kërkimit shkencorë për fjalëformimin, e cila përkon me interesin teorik në rritje për një studim më të thelluar të strukturës së gjuhës shqipe, sidomos të strukturës gramatikore dhe leksikore. Fjalëformimi filloi të shihej si një sistem i ndërmjetëm, në raport të ngushtë me sistemin gramatikor e leksikor, si rrugë kryesore e pasurimit dhe e zhvillimit leksikut të gjuhës shqipe. Nën këtë aspekt, në Institutin e Lartë Pedagogjik që prej 1955 dhe më vonë, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës u mbajt nga gjuhëtari A. Kostallari një kurs i plotë teorik mbi fjalëformimin. Gjatë këtyre leksioneve teorike, pas rishqyrtimit në mënyrë kritike të vlerave të së shkuarës, u

⁸ K. Cipo, *Kompozitat determinative* në BISH, 2-3, 1948 dhe në "Çështje të gramatikës së shqipes ë s sotme" II, Tiranë, 1975.

⁹ A. Xhuvani, *Origjina dhe formimi i ndajfoljeve*, "Studime gjuhësore", Tiranë, 1956; në "Çështje të gramatikës së shqipes ë s sotme" II, Tiranë, 1975 dhe në A. Xhuvani, "Vepra" I, Tiranë, 1980.

¹⁰ A. Xhuvani, *Kompozitat* në "Studime gjuhësore", Tiranë, 1956 dhe në "Vepra" I, Tiranë, 1980.

¹¹ A. Xhuvani, *Prapashtesat –më, -imë, -im*, në "Vepra" I, Tiranë, 1980.

formuluan për herë të parë koncepte të reja mbi fjalëformimin në gjuhën shqipe. Në këtë kurs është trajtuar në mënyrë të plotë karakteri abstrakt i fjalëformimit në raport me abstraksionin gramatikor e leksikor dhe janë dhënë në planin teorik karakteristikat themelore të mënyrave kryesore të fjalëformimit në shqip: ndajshesimi, përbërja dhe përngjitja, si dhe formimi pa ndajshesë. Në këtë kurs është trajtuar gjithashtu për herë të parë formimi parashtesoro-prapashtesor me veçantitë e tij tipike në gjuhën shqipe.

Kjo analizë teorike e përgjithshme u ndoq nga një seri studimesh nga i njëjti autor, A. Kostallari. Artikuj të thelluar iu kushtuan posaçërisht ndërtimeve dhe formimeve të fjalëve me temë të përbërë. Ndërmjet punimeve të këtij autori citojmë: 1) *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe* (1961); 2) *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese* (1962); 3) *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes* (1968); 4) *Kontribut për klasifikimin e tipave kryesorë të kompozitave në fushën e mikrooronimeve shqiptare* (1969). Nisi gjithashtu analiza e strukturës semantike të kompozimeve pronore të shqipes (1965).

Këto studime mbi fjalëformimin u ndoqën nga një seri punimesh me tematikë më të larmishme, në të cilat u trajtuan për herë të parë, ose në mënyrë më të thelluar, probleme të tilla si:

- a) mënyrat, tipat dhe mjetet e formimit të fjalëve sipas pjesëve të ndryshueshme e të pandryshueshme të ligjëratës (p.sh. emra, mbiemra, ndajfolje, pjesëza, pasthirra etj.);
- b) roli e ndajshesave të ndryshme për formimin e fjalëve;
- c) norma letrare në fushën e fjalëformimit në gjuhën shqipe;
- ç) formimi i kategorive të ndryshme leksiko-semantike me ndihmën e mjeteve të fjalëformimit;
- d) kontributi i shkrimtarëve të ndryshëm të letërsisë shqipe në fushën e fjalëformimit, etj.

Ndërmjet punimeve të shumta të botuara gjatë kësaj periudhe, sipas tematikës, kemi renditur disa prej tyre, si vijon:

a) për probleme të strukturës së fjalëve nga: M. Çeliku, *Mbi analizën strukturore të fjalës* (1964); J. Thomaj, *Mbi disa çështje të leksikut e të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme letrare shqipe* (1973);

b) për kriteret e dallimit të prejardhjes parashtesore nga: E. Hysa, *Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe* (1973); E. Hysa, *Formimet me parashtesë në shqipen e sotme letrare* (1975);

c) për mënyrat, tipat dhe mjetet e formimit të pjesëve të ndryshueshme e të pandryshueshme të ligjëratës nga: A. Xhuvani, *Parafjalët* (1964); Sh. Demiraj, *Emrat prejfoljorë asnjans dhe toqjet me vlerë foljore të formuara me pjesëmarrjen e tyre* (1969); Sh. Demiraj, *Rreth ndajfoljezimit (adverbializimit) të disa formave gramatikore dhe të disa toqeve të tipit parafjalë + emër* (1970); A. Dhimo, *Subsantivimi i mbiemrave*

(1971); A. Dhimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe* (1972); E. Hysa, *Formime ndajfoljore me prapashtesa në shqipen e sotme letrare* (1970); J. Kole, *Një vështrim mbi emrat e prejardhur në –ore*, SF, 1970/4, f. 33-46;

ç) për probleme të normës në fushën e fjalëformimit nga: J. Thomaj, *Mbi disa çështje të normës në fushën e leksikut dhe të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme letrare shqipe* (1972);

d) për ndikimin e gjuhëve të huaja në formimin e fjalëve të shqipes nga F. Podgorica, *Parashtesat e huazuara* (1969);

e) formimi i fjalëve sipas kategorive leksiko-semantike nga: V. Milkani, *Vëzhgime mbi emërtimet e njerëzve sipas profesionit* (1970); L. Buxheli, *Emrat e veprimit me prapashtesat –im dhe –je në gjuhën letrare shqipe*, SF, 1981/4, f. 55-66; L. Buxheli, *Emrat prejfoljorë të paranyjësuar me kuptimin e veprimit në gjuhën e sotme letrare shqipe* SF, 1983/2, f. 143-156; L. Buxheli, *Emrat foljorë me prapashtesat –esë, –më, –imë, –atë, –i në gjuhën e sotme shqipe*, SF, 1984/1, f. 97-112;

f) formimi i fjalëve dhe lidhja e tij me derivacionin semantik nga Jani Thomaj në disa artikuj, si: *Formimi i fjalëve dhe prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, SF, 1983/3, f. 53-89; *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesën –isht në gjuhën shqipe*, SF, 1993/1-4, f. 11-28; *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesën –shëm në gjuhën shqipe*, SF, 1989/3, f. 55-72;

g) roli i letërsisë artistike për pasurimin e leksikut të shqipes me fjalë të reja jo të parme nga: M. Domi, *Disa shënime për gjuhën e Petro Nini Luarasit* (1974); H. Shehu, *Rreth pasurimit të fjalëve të përbëra në gjuhën e sotme letrare shqipe*, SF, 1988/1, f. 85-103, etj.

Për disa nga këto çështje, që lidhen me nevojën e ngritjes së nivelit teorik të studimeve gramatikore, por edhe me metodologjinë e studimit të strukturës së brendshme të fjalës, sidomos me rolin e morfemave dhe dallimin e analizës së strukturës morfematike nga ajo fjalëformuese, në të vërtetë është folur edhe më herët, fillimisht në gramatikën e Sh. Demirajt (1961) dhe më pas nga S. Riza në dorëshkrimin e tij “*Disa teza mbi teorinë dhe praktikën e analizës morfologjike përshkruese shqip*” të 4 gushtit të vitit 1964, të ruajtur në arkivin e familjes, por që u bë i njohur nga gjuhëtari Rexhep Ismajli vetëm pas vdekjes së tij¹².

Të gjitha këto studime, përfshirë këtu edhe kontributin e S. Rizës, ndonëse të pasqyruar në bibliografinë e gramatikës akademike 1, përbënë bazën e kapitujve për fjalëformimin në dy veprat shkencore me karakter normativ: *Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (1976) dhe *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Morfologjia* (1976). Kreu për strukturën

¹² S. Riza, *Disa teza mbi teorinë dhe praktikën e analizës morfologjike përshkruese shqip*, në “SELMAN RIZA, VEPRA IV”, PRISHTINË 2004, f. 43-44.

morfologjike të fjalës, hartuar nga E. Lafe në të dy botimet është një pasqyrim i përgjithësuar e sistematik i mënyrave, i tipave dhe mjeteve të fjalëformimit në shqip, të para qoftë në planin e përgjithshëm të sistemit të gjuhës, qoftë në kuadrin e veçantë të formimit sipas pjesëve të ligjëratës. Për herë të parë në historinë e gramatologjisë shqiptare, duke përqafuar arritjet më të mira të gjuhësisë bashkëkohore perëndimore në fushën e morfologjisë, u pasqyruan në një gramatikë shkencore konceptet bashkëkohore të morfemës, të analizës morfematike, të strukturës morfologjike dhe të fjalëformimit, të produktivitetit etj. Tani fjala nuk konsiderohet si një copëzim mekanik, por si një sistem morfemash, njësisht më të vogla të kuptimshme, të cilat si pjesë përbërëse të fjalës, marrin përsipër funksione të ndryshme të fjalëformimit dhe të formëformimit. Veç kësaj, analiza e mënyrave, tipave dhe mjeteve fjalëformuese të leksikut të shqipes, si pjesë e sistemit fjalëformues të saj, është më e plotë. Në Gramatikën Akademike (1976, 1995, 2002)¹³ që në botimin e parë njohuritë për sistemin fjalëformues të shqipes pasurohen me të dhëna të reja, të patrajuara më parë, jo vetëm për mënyra të tilla si paranyjëzimi, konversioni, mënyrat e përziera, por edhe për çështje që kanë të bëjnë me dukuri që shoqërojnë procesin e fjalëformimit si dukuria e shndërrimit të një morfeme trajtëformuese në morfemë fjalëformuese (*shumëkat-ësh*), ose dukuria e ndryshimeve në strukturën e fjalës si p.sh. të ashtuquajturat dukuria e thjeshtimit (qëllim: *-im* nuk interpretohet më si prapashtesë; *burracak*: *-acak* është bashkim i dy prapashtesave), dukuria e alomorfeve etj.

4. Pas viteve '90 prurjet në fushën e fjalëformimit nuk kanë munguar, ndonëse me një ritëm më të ulët. Ato janë studime monografike dhe artikuj të veçantë, të botuar në revista gjuhësore. Përsëri problematika është e gjerë dhe e larmishme dhe këndvështrimet janë të ndryshme. Pikënisje ose objekt studimi i disa monografive janë, sipas rastit, pjesët e ligjëratës sipas fjalëformimit, ndajshësia fjalëformuese të caktuara, një mënyrë fjalëformimi e caktuar ose një grup leksikosemantik i caktuar. Ndër pjesët e ligjëratës janë studiuar në planin fjalëformues emrat me ndajshësia nga Enver Hysa¹⁴ dhe struktura fjalëformuese e foljeve nga L. Buxheli¹⁵ ose e një grupi të caktuar foljesh nga N. Veselaj¹⁶. Ndër mënyrat e fjalëformimit ka tërhequr vëmendjen roli i përngjitjes në pasurimin e leksikut të shqipes me fjalë të reja (L.

¹³ *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2002.

¹⁴ E. Hysa, *Formimi i emrave me parashtesa dhe prapashtesa*, Tiranë, 2005, 205 faqe.

¹⁵ L. Buxheli, *Formimi i foljeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2008, 300 faqe.

¹⁶ N. Veselaj, *Foljet më –O në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2002, 200 faqe.

Buxheli)¹⁷, kurse në ndër grupet leksiko-semantike përsëri bëhen objekt studimi emrat e profesionit (N. Veselaj)¹⁸.

Me interes pas viteve '90 janë edhe artikujt për çështje të veçanta të formimit të fjalëve në shqipen e sotme nga H. Shehu¹⁹, A. Vehbiu²⁰, Th. Feka²¹, A. Çepani²². Në qendër të vëmendjes së këtyre artikujve janë përsëri dy mënyrat kryesore të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme shqipe, prejardhja dhe kompozimi, lloje të veçanta ndajshitesash pak të trajtuara si p.sh. sindajshitesat, por pa lënë mënjanë edhe studimin e formimeve të fjalëve sipas kategorive leksikosemantike të caktuara ose sipas një gjinie letrare të caktuar. Përgjithësisht vëmendja përqendrohet në gjuhën e letërsisë artistike. Nuk mungojnë edhe studime krahasuese për probleme të fjalëformimit në kuadrin e shqipes si gjuhë ballkanike (V. Memisha)²³ dhe ato të fjalëformimit të autorët e vjetër (I. Arapi)²⁴. Po ashtu, ka pasur edhe botime të posaçme me përmbledhje studimesh për leksikun e fjalëformimit në gjuhën shqipe.²⁵

Nga ana tjetër, për shkak të interesave teorike në rritje dhe nevojës për një analizë më të thelluar të dukurive fjalëformuese, nuk kanë munguar përpjekjet për njohjen dhe zbatimin e teorive dhe koncepteve të reja bashkëkohore në fushën e fjalëformimit, që kanë të bëjnë me probleme të tilla si p.sh. përcaktimi i vendit të fjalëformimit (si pjesë e morfologjisë, e leksikologjisë apo si një disiplinë më vete), pranimi i prapashtesave zero²⁶, roli klasifikues i ndajshitesave fjalëformuese ose roli i kokës fjalëformuese, dukuria e perkolacionit në fjalëformim ose aftësia e ndajshitesave fjalëformuese për të përçarur të fjala e re tiparet kuptimore e gramatikore, bashkëveprimi i fjalëformimit me fusha të tjera gjuhësore, sidomos me fonologjinë leksikore

¹⁷ L. Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, 322 faqe.

¹⁸ N. Veselaj, *Rreth formësimit të emërimit të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2014, 290 faqe.

¹⁹ H. Shehu, *Rreth sindajshitesave në gjuhën e sotme shqipe*, SF 1989/2, f. 145-153; H. Shehu: *Formimet me gjymtyrë të parë të mën vetë- në gjuhën e sotme letrare shqipe* SF 1990/3, f. 113-126.

²⁰ A. Vehbiu, *Emërtimet e njerëzve sipas mjeshtërisë me prapashtesat -ar, -or, -tar e -tor në shqipen e sotme letrare* SF, 1986/1, f. 105-121; *Vëzhgime për disa kompozita pronësore në poezinë e sotme shqiptare*, SF, 1987/1, f. 121-138; A. Vehbiu, *Një tip i veçantë kompozitash përcaktore të leksikut poetik të shqipes* SF, 1991/1, f. 91-97.

²¹ Th. Feka, *Fjalëkrijimi si mjet poetik në veprën e Lasgush Poradecit*, SF, 2013/1-2, f. 163-168.

²² A. Çepani, *Rreth problemit të sindajshitesave në gjuhën shqipe*, SF, 2005/3-4, f. 141-159.

²³ V. Memisha, *Mbiemrat prejpesorë në shqipe dhe në greqishte*, SF, 2007/3-4, f. 59-71.

²⁴ I. Arapi, *Tipat strukturorë të mbiemrave në veprën "Çeta e profetëve" të Pjetër Bogdanit*, SF, 1990/1, f. 41-56.

²⁵ *Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve* (Tiranë 1972, Tiranë, 2002).

²⁶ *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2002, f. 48.

dhe semantikën, çështje të dallimit të ndajshesave eptimore nga ato fjalëformuese sidomos të disa folje të prejardhura në formë joveprorë etj.

Ndonjë prej këtyre koncepteve e problemeve nuk është krejtësisht i panjohur në gjuhësinë shqiptare. Kemi parasysh gramatikën akademike, por më herët edhe studimet e Xhuvani-Çabejt për parashtesat e prapashtesat, në të cilat ndonëse nuk përmendet termi “kokë leksikore” ose “kokë fjalëformuese” pohohet me të drejtë se parashtesat fjalëformuese nuk e ndryshojnë kategorinë leksiko-gramatikore të fjalëve, kurse prapashtesat po²⁷. Megjithatë ky shpjegim i gramatikës, për rolin klasifikues të prapashtesave ose konceptin e kokës leksikore dhe rolin e saj në fjalëformim nuk është i mjaftueshëm, sepse ka raste kur prapashtesa nuk e ndryshon kategorinë leksiko-gramatikore, e përsëri fjala e re ka një kokë leksikore, por kjo dukuri në fjalë të tilla kërkon një shpjegim më të thelluar, siç është p.sh. rasti i mbiemrave me lidhje fjalëformuese i *bardhë-osh>bardhosh* ose i derivacioneve emërore të tipit *lepur-ush>lepurush*, por edhe i formimeve parashtesore.

Një çështje e diskutueshme për shkak të këndvështrimeve të ndryshme, në këto vitet e fundit, është problemi i vendit të fjalëformimit në strukturën gramatikore të shqipes. Ky problem ka tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe lidhet ngushtë me konceptin për morfologjinë si morfologji fjalëformuese dhe morfologji eptimore.

Në gjuhësinë shqiptare studimet për fjalëformimin janë bërë si nga gramatikanë ashtu edhe nga leksikologë, dukuri kjo që shpjegohet edhe me trajtimin e fjalëformimit si një disiplinë e ndërmjetme, midis morfologjisë e leksikologjisë. Megjithatë, ndonëse ka mbizotëruar mendimi se fjalëformimi është një fushë e ndërmjetme, një koncept të tillë nuk ndeshet në gramatikën e gjuhës shqipe 1, 2002, pasi fjala në të nuk shihet si njësi leksikore, por si një formë që ndryshon nëpërmjet eptimit ose mjeteve fjalëformuese. Në këtë gramatikë jo vetëm bëhet një përshkrim i hollësishëm i strukturës fjalëformuese të shqipes, por edhe një përcaktim deri diku i qartë i vendit të fjalëformimit në strukturën gramatikore të shqipes. Fjalëformimi shihet si një proces morfologjik dhe morfologjiko-sintaksor, që lidhet me formën e fjalës dhe rolin e mjeteve fjalëformuese. Pra fjalëformimi përshkruhet si një proces morfologjik që ka të bëjë me ndryshimin e formës së fjalëve, si një ndryshim që ka si pasojë krijimin e një fjalë e re²⁸. Kemi të bëjmë kështu me një morfologji fjalëformuese, e cila qëndron krahas morfologjisë eptimore, objekt i së cilës janë pjesët e ligjëratës sipas aftësive që kanë për të ndryshuar formën e eptimit.

Përveç gramatikës akademike, mendime me interes për strukturën fjalëformuese të shqipes dhe vendin e fjalëformimit si disiplinë gjuhësore

²⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2002, f. 64-65.

²⁸ *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2002, f. 29.

pasqyrohen edhe në artikujt e G. Turanos²⁹ e të Sh. Islamajt³⁰. Duket qartë që kemi të bëjmë me një çështje të diskutueshme. Ndërsa Turano e interpreton morfologjinë si disiplinë gjuhësore që studion proceset morfologjike eptimore ose fjalëformuese, të cilave u nënshtrohet fjala, duke nënkuptuar kështu një morfologji fjalëformuese krahas asaj eptimore, Islamaj e trajton fjalëformimin jo si nëndarje të morfologjisë, por si disiplinë e veçantë, pjesë e së cilës duhet bërë edhe derivacioni semantik.

5. Pas viteve '90, ndryshimet e mëdha shoqërore-ekonomike e politike kanë lënë gjurmët e tyre edhe në leksik, si fusha më e ndjeshme e strukturës gjuhësore. Veçanërisht gjatë kësaj kohe ka pasur e vijon të ketë ndikime nga gjuhët e huaja, të cilat shfaqen jo vetëm në futjen e fjalëve të huaja shumë herë të panevojshme, por edhe të mjeteve fjalëformuese. Shpeshherë këto ndikime shoqërohen edhe me probleme drejtshkrimore që shfaqen sidomos në shkrimin e fjalëve të formuara me parashtesa, por edhe në shkrimin e fjalëve të përbëra e të përngjitura. Kjo e bën të nevojshëm jo vetëm vijimin e punës studimore të mëtejshme për një studim më të thelluar të dukurive fjalëformuese, por edhe rishikimin ose sqarimin më të mirë të ndonjë dukurie fjalëformuese në studimet për fjalëformimin.

Gramatika akademike e gjuhës shqipe është ribotuar e përmirësuar, por ndryshime thelbësore në përshkrimin e strukturës fjalëformuese të shqipes nuk ka pasur. Në të është saktësuar ndonjë analizë për ndonjë mjet fjalëformues ose është përcaktuar më mirë lloji i mjetit fjalëformues për tipa të caktuar fjalësh, siç është p.sh. interpretimi i formimeve prejfoljore emërore të tipit *mësues* si formime me prapashtesën *-ues*, siç propozojnë Xhuvani-Çabej në studimin e tyre për prapashtesat në gjuhën shqipe, por megjithatë ka vend për plotësime e sqarime të mëtejshme³¹. Megjithatë, një arsye tjetër që e bën të nevojshëm rishikimin e fjalëformimit në këtë gramatikë është mënjanimi, në ndonjë rast, i mungesës së koherencës në shpjegimin e dukurive fjalëformuese. Kjo mungesë koherence shpjegohet me njëfarë nxitimi gjatë hartimit të kapitujve, por në ndonjë rast edhe me vështirësitë për shpjegimin e ndonjë çështjeje të diskutueshme.

E dukshme është mungesa e koherencës në analizën fjalëformuese të pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, përkatësisht te ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat dhe pjesëzat. Nuk shpjegohet qartë p.sh. kufiri ndarës ndërmjet strukturës morfematike dhe asaj fjalëformues të këtyre fjalëve. Me përjashtim

²⁹ G. Turano, *Proceset e fjalëformimit të gjuhës shqipe në përqasje me ato të italishtes nën këndvështrimin e teorisë leksikaliste*, SF, 2012/1-2, f. 91-116.

³⁰ Sh. Islamaj, *Trajtimi i fjalëformimit në gjuhësinë shqiptare*, Gjuha shqipe, 2, 2004.

³¹ A. Xhuvani-E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962 dhe në A. Xhuvani, "Vepra" I, Tiranë, 1980.

të lidhëzave³², të cilat përshkruhen qartë sipas strukturës morfematike (fjalë të thjeshta e jo të thjeshta) dhe asaj fjalëformuese (me konversion, përngjitje, lokucion), në shumicën e rasteve termi “strukturë” përdoret edhe për përshkrimin morfematik, edhe për përshkrimin fjalëformues³³. Për pasojë, analiza morfematike dhe fjalëformues del e cunguar. Kështu p.sh. në rastin e ndajfoljeve, ndonëse trajtohen si zëra më vete struktura dhe formimi i tyre, zbatimi i këtij kriteri nuk është i qartë. Kur flitet për strukturën e ndajfoljeve, informacioni që jepet nuk ka të bëjë me natyrën e tyre si fjalë të thjeshta ose jo të thjeshta, me llojin dhe numrin e morfemave (rrënjore ose jorrënjore), por me mënyrën e formimit të këtyre fjalëve, p.sh. nëpërmjet prejardhjes³⁴. Ndërkohë, më pas, nën titullin “Formimi i ndajfoljeve” këto fjalë përshkruhen sipas mënyrës së formimit³⁵.

Mungesa e koherencës vërehet në ndonjë rast edhe në përcaktimin jo të njëjtë të mënyrave të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe. Këtë dukuri e ndeshim si brenda të njëjtë botim akademik, ashtu edhe duke krahasuar botime të ndryshme. Kështu, në gramatikën e gjuhës shqipe 1, ndërsa në kreun e parë të Gramatikës së gjuhës shqipe 1, kushtuar strukturës morfologjike e fjalëformuese nuk dallohet si mënyrë me vete formimi i fjalëve me anë të lokucionit³⁶, në kapitujt për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës lokucioni shihet edhe si tipar strukturor edhe si mënyrë fjalëformimi. Duket qartë që kemi të bëjmë me një çështje teorike të diskutueshme, nëse lokucioni duhet pranuar ose nuk duhet pranuar si mënyrë fjalëformimi.

Nga ana tjetër, ndërsa në gramatikën akademike emrat e tipit *hap-i*, *mund-i*, *shkul-i* ose foljet e tipit *huaj*, *krip*, *kuq*, *ndryshk*, *sit*, *shëndosh* etj. interpretohen si formime pa ndajshtesa, në Leksikologjia e gjuhës shqipe interpretohen si formime me konversion.

Një problem tjetër lidhur me studimet në fushën e fjalëformimit ka të bëjë me metodologjinë e punës. Prurjet në fushën e këtyre studimeve tregojnë se ka vend për përsosje të metodologjisë së punës studimore, mënyrës së të studiuarit të problemeve fjalëformuese, ku përveç përcaktimit të bazës teorike, rëndësi të veçantë merr edhe mënyra e përzgjedhjes së të dhënave gjuhësore fjalëformuese. Përgjithësisht studimet tona për fjalëformimin, sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit (1972), janë përqendruar në shqipen letrare, duke lënë mënjanë të folmet e dialektet. Pak vëmendje u është kushtuar të dhënave fjalëformuese që mund të sillen nga leksiku dialektor, nga të folmet e ndryshme sipas krahinave ose sipas shtresave sociale.

³² *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2002, f. 399, 403-404.

³³ *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2002, f. 388, 414, 430.

³⁴ *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2002, f. 359.

³⁵ *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2002, f. 370-380.

³⁶ *Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Tiranë, 2002, f. 43-79.

6. Por, pas viteve '90, në fushën e studimeve për formimin e fjalëve vërehen edhe disa dukuri të tjera që në mënyrë indirekte kanë ndikuar në studimet për fjalëformimin. Në kushtet e sotme, për shkak të ndryshimeve politike-shoqërore, puna kërkimore shkencore në përgjithësi, por edhe për fjalëformimin, në veçanti, nuk është më e përqendruar në një institucion të vetëm kërkimor-shkencor. Kjo ka sjellë një pavarësi më të madhe të këtyre institucioneve dhe të lirisë akademike. Por nga ana tjetër, ndonëse interneti është një burim shumë i mirë informacioni, vërehet një informacion i mangët për botimet në këtë fushë, qoftë të atyre në trojet shqiptare dhe në diasporë, qoftë edhe të botimeve në gjuhë të huaj, gjë që pasqyrohet edhe në bibliografinë e përdorur nga studiuesit, e cila shpeshherë është e papërditësuar. Organizimi dhe bashkërendimi më i mirë i punës nga ana e institucioneve kërkimore dhe i bibliotekave për përditësimin e studiuesve me informacione për botimet e reja nga studiues shqiptarë e të huaj mendojmë se është një domosdoshmëri, sepse do të ndihmonte më shumë në mbarëvajtjen e punës kërkimore-shkencore jo vetëm në fushën e fjalëformimit, por edhe të studimeve gjuhësore në përgjithësi.

BIBLIOGRAFI

- Androkli Kostallari, *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit të strukturës së gjuhës sonë letrare*, "Studime filologjike", 1982/2, f. 3-37.
- Enver Hysa & Remzi Përnaska, *Studimet gramatikore gjatë 40 vjetëve të Çlirimit*, "Studime filologjike", 1985/1, f. 3-19.
- Mahir Domi, *Gjuhësia shqiptare në 35-vjetorin e çlirimit*, "Studime filologjike", 1979/4, f. 3-15.
- Redaksia, *Horizonte të reja për shkencat tona filologjike*, "Studime filologjike", 1980/3, f. 3-7.
- Redaksia, *Shkencat filologjike në 40-vjetorin e Çlirimit*, "Studime filologjike", 1984/4, f. 3-9.